

BULETINI TREMUJOR
FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS



TRUSTORJA

PERFORMANCA KUMULATIVE E FKPK-SË PREJ THEMELIMIT



| PERIUDHA | 1M | 3M | 1V | 3V | 5V | NGA THEMELIMI |
|------------|--------|--------|--------|---------|---------|----------------|
| REZULTATI | -0.17% | +1.57% | +7.54% | +16.67% | +36.96% | +36.89% |
| BENÇMARKU* | +0.20% | +0.40% | +0.63% | +0.72% | +5.14% | +31.10% |

*INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT I PUBLIKUAR NGA AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

PERFORMANCA DHE KTHIMI NGA INVESTIMET NË TM3 2016

ÇMIMI I AKSIONIT:

| | |
|----------------------------------|-----------------|
| KORRIK | ▲ +2.08% |
| GUSHT | ▼ -0.33% |
| SHTATOR | ▼ -0.17% |
| GJITHSEJ PERFORMANCA NETO | ▲ +1.57% |

KTHIMI BRUTO:

| | |
|------------------------------|--------------------|
| KORRIK | +€28.12 mln |
| GUSHT | -€4.05 mln |
| SHTATOR | -€1.69 mln |
| GJITHSEJ KTHIMI BRUTO | +€22.37 mln |

FAKTET KRYESORE

ÇMIMI I AKSIONIT
€1.3689

MJETET NETO NËN MENAXHIM
€1,323,691,671.57

PENSIONE TË SHPAGUARA KËTË TREMUJOR
€4.83 mln

PENSIONE TË SHPAGUARA KËTË VIT
€14.33 mln

LLOGARI TË PENSIONUARA KËTË TREMUJOR
1,243

LLOGARI TË PENSIONUARA KËTË VIT
3,520

LLOGARI TË KONTRIBUESVE
531,636

LLOGARI AKTIVE NË FUND TË PERIUdhËS
293,112

KONTRIBUES TË RINJ KËTË VIT
23,706

KONTRIBUTE KËTË TREMUJOR
€37.17 mln

SHËRBIME TË OFRUARA KËTË VIT
60,000

GJITHSEJ LLOGARI TË AKTIVIZUARA NË eTRUSTI
57,163

PLASMANET DHE PERFORMANCA PËR SECILIN MENAXHUES/EMETUES

| MENAXHUESI/EMETUESI | EMRI I FONDIT/INSTRUMENTIT /BANKËS | PLASMANET | PJESËMARRJA | PERFORMANCA |
|-------------------------------------|------------------------------------|--------------------------|---------------|---------------|
| Vanguard | Global Stock Index Fund - Euro | €359,607,459.67 | 26.08% | +4.39% |
| BNY Mellon | Global Real Return Fund | €215,747,811.62 | 15.65% | +0.42% |
| Schroders | Strategic Bond - Euro Hedged | €10,079,561.34 | 0.73% | +1.80% |
| Nordea | 1-Stable Return Fund | €237,541,428.70 | 17.23% | +0.22% |
| AXA | Global Inflation Linked Bonds | €88,075,135.63 | 6.39% | +3.12% |
| Thesari i Republikës së Kosovës | Obligacione dhe fletobligacione | €106,374,061.62 | 7.71% | +0.50% |
| Nordea | 1-Global Stable Equity Fund | €163,004,937.71 | 11.82% | +0.56% |
| Pictet | High dividend selection Z EUR | €42,384,763.22 | 3.07% | +2.55% |
| AXA | WF Optimal Income I EUR | €59,745,053.94 | 4.33% | +3.34% |
| Schroders** | ISF Global Diversified Growth | €40,024,035.06 | 2.90% | +0.68% |
| BANKA KOMBËTARE TREGTARE | Depozitë me afat | €3,047,262.52 | 0.22% | +0.42%* |
| BANKA PËR BIZNES SH.A. | Depozitë me afat | €3,041,794.52 | 0.22% | +0.37%* |
| GJITHSEJ MJETE TË INVESTUARA | | €1,328,673,305.55 | 96.35% | +1.57% |

*Performanca në këto raste është për çështje ilustrimi dhe nuk lidhet me investimin, pasi janë depozita me afat, me interes të paracaktuar. Norma e paraqitur është për interesin e mbledhur për periudhën 31 korrik 2016 deri më 30 shtator 2016.

**Ky është investim i ri në fondin e Schroders ISF Global Diversified Growth që është realizuar më 6 gusht 2016 në vlerë prej 40 milionë euro. Rrjedhimisht edhe performanca investuese është vetëm për periudhën prej 06.08.2016 deri më 30.09.2016.

€22.4 MLN KTHIMI BRUTO PËR TM3

Ky tremujor rezultoi me një kthim të kënaqshëm nga investimet, duke ofruar më shumë stabilitet, që është edhe vetë qëllimi i strategjisë investuese, sesa ndjekje të indekseve kryesore të tregjeve. Për këtë periudhë kthimi bruto nga investimet ishte rreth €22.4 mln, kurse kthimi nga investimet për vitin shkoi në rreth €55.8 mln. Kjo performancë u reflektua me një rritje neto prej 1.6% të çmimit të njësisë për TM3, dhe me çmimin e aksionit që arriti në €1.3689. Si rezultat i kontributeve të reja dhe performancës nga investimet, mjetet nën menaxhim u ngritën për 54.3 mln në TM3, për të shkuar kështu në gati €1.38 mld. Në anën tjetër për këtë tremujor FKPK-ja mbajti €281 mijë për tarifën operacionale, €1.36 mln për tarifën investuese dhe rreth €931 mijë ishin refundime.

FAKTORËT ME NDIKIM

Tremujori i tretë ishte në përgjithësi pozitiv për tregjet, dhe luhatshmëria në tregun e aksioneve dhe bonove ishte më e ulët sesa në dy tremujorët paraprak. Tregu i aksioneve njohu përmirësim si në qendrat kryesore financiare por ashtu edhe në periferi dhe në tregjet në zhvillim. Kjo ngritje u bazua në përmirësimin e treguesve ekonomikë dhe performancën tejet pozitive të sektorëve më me peshë, si IT dhe financa. Edhe tregu i bonove, nën kushtet e forcimit të monedhave kryesore, u stabilizua nga referendumi pro BREXIT dhe njohu përmirësim.

PERFORMANCA E FONDEVE INVESTUESE

Të gjitha fondet investuese të angazhuara ishin me rezultat pozitiv për periudhën, duke ilustruar kështu gjendjen e mirë të të gjitha instrumenteve investuese. Po ashtu ndryshimi mes performancës më të lartë dhe më të ulët ishte më i vogël se në tremujorët paraprak. Fondi i Vanguard GSIF ishte me performancën më të mirë (+4.39%) duke përfituar nga performanca e jashtëzakonshme e sektorit të IT-së; e që kompanitë kryesore të globale të këtij sektori janë në top 10 plasmanet e Vanguard. Më pas ishte fondi i AXA WFOI (+3.34%), me pozicionim tejet të balancuar mes alokimeve në aksione dhe bono e me përqendrim në Eurozonë. Jo larg, me +3.12%, ishte edhe fondi tjetër i AXA-s, AXA GILB, që e kishte avantazh rritjen e inflacionit global. Edhe dy fondet e pastra, Pictet në aksione (+2.55%) dhe Schroders në bono (+1.80%), treguan performancë të kënaqshme duke ndjekur prirjen globale të rritjes së tregjeve. Ndërsa dy fondet e Nordea-s, Nordea GSEF (+0.56%) dhe Nordea SRF (+0.22%), ishin dukshëm nën mesataren e rritjes së tregjeve, falë strategjive të tyre investuese që synojnë të ofrojnë mbrojtje kur tregjet janë në rënie por rriten më pak kur tregjet ngriten. Kësaj logjike i bashkëngjitet edhe fondi i BNY Mellon (+0.42%) në multi-asete, me plasmane po ashtu specifike. Jashtë analizës për këtë periudhë ngelet fondi i Schroders ISF GDG, për shkak se investimi është bërë më 6 gusht dhe nuk përkon me periudhën e plotë të TM3.

PERFORMANCA NETO E INVESTIMEVE NË TM3

+1.57%

PERFORMANCA NETO E INVESTIMEVE PËR VITIN

+3.93%

Investimet në Kosovë ishin me norma të paracaktuara të interesit dhe nuk ndikohen nga faktorë të jashtëm. Interesi i mbledhur për periudhën për investimet në depozita ishte mesatarisht 0.39%, dhe për bono 0.50%. Edhe pse FKPK-ja vazhdon të marrë pjesë në ankandet e shpallur nga Qeveria, normat e interesit që ofrohen nga pjesëmarrësit kanë vazhduar të jenë tejet të ulëta dhe si të tilla FKPK-ja nuk ka rezultuar e suksesshme me normat minimale të pranueshme për Bordin.

LAJMET KRYESORE TË TREMUJORIT

BORDI MBAJTI MBLEDHJEN E TRETË PËR VITIN

Në mbledhjen e shtatorit Bordi mori këto vendime kryesore:
1) Të alokohen €40 mln në Amundi në momentin që hapet llogaria aty; 2) Miratohen tarifat menaxhuese që do t'i dërgohen Kuvendit për konfirmim si: 0.393% të financimin e aktiviteteve investuese dhe 0.082% për financimin e aktiviteteve operacionale; 3) Të mbahet në fuqi Manuali i Investimeve, strategjia dhe alokimet aktuale; 4) Të publikohet konkursi për angazhimin e më së shumti dy kandidatëve për departamentin e Investimeve dhe Riskut.

BNP PARIBAS IP – PARVEST DIVERSIFIED DYNAMIC (I) I SHTOHET LISTËS INVESTUESE

FKPK ka realizuar investimin e parë prej €40 mln në fondin e BNP Paribas Investment Partners - Parvest Diversified Dynamic (I). BNP Paribas IP është në top listën e institucioneve financiare dhe investuese në botë. Deri më 30 qershor 2016 BNP Paribas IP kishte 532 mld mjete nën menaxhim, mbi 3,000 të punësuar dhe me shtrirje në 34 vende e në pesë kontinente. Fondi Parvest Diversified Dynamic synon të rrisë vlerën e asetëve në periudhë afatmesme duke zbatuar një strategji të diversifikuar dhe fleksibile të alokimit në të gjitha klasat e asetëve. Bordi Drejtues e ka përzgjedhur këtë fond përmes një procesi të hapur të konkurrimit, duke marrë për bazë një sërë kriteresh.

NDRYSHOJNË PRAGJET E TËRHEQJES SË PENSIONIT TË MOSHËS

Prej shtatorit 2016 kanë hyrë në fuqi ndryshimet në pragjet e tërheqjes së kursimeve pensionale. Kështu të gjithë përfituesit e pensionit të moshës që kanë në bilanc deri në €3,000 mund ta tërheqin gjithë shumën në një pagesë të vetme. Ndërsa të gjithë përfituesit e tjerë, me bilanc mbi €3,000, do t'i tërheqin kursimet pensionale në faza, pra çdo muaj, por tashmë nga së paku €200 euro. Kujtojmë se deri më këtë periudhë tërheqja e menjëhershme vlente për bilancet derinë €2,250 dhe tërheqjet në faza ishin €150.

4 BANKA DO TË OFROJNË TËRHEQJEN NË FAZA

Prej shtatorit 2016 të gjithë përfituesit e pensionit nga FKPK-ja do të mund t'i tërheqin kursimet pensionale në faza përmes katër bankave: TEB, NLB, BPB dhe Banka Ekonomike. Ka qenë iniciativë e FKPK-së që përfituesve të pensionit t'ju ofrojë më shumë mundësi për tërheqje të kursimeve, duke synuar që të përfshijë në këtë program të gjitha bankat e interesuara. Tërheqja përmes këtyre bankave vlen për të gjithë të pensionuarit e moshës, që kanë bilanc të akumuluar me mbi €3,000 euro.

MBI 4.8 MLN PENSIONE NË TM3

Mbi €4.8 mln ishin mjetet që u transefuran në llogaritë e pensionuara në tremujorin e tretë. Këto mjete shkuan tek 1,243 përfitues të pensionit. Nga këta: 994 ishin pensionime të moshës, 57 ishin raste të invaliditetit dhe 192 ishin raste të vdekjes.

Për nëntëmëujorin e vitit 2016 vlera e mjeteve të transferuara tek të pensionuarit ka arritur në rreth €14.3 mln për 3,520 përfitues.

57,163 LLOGARI NË eTRUSTI

Numri i kontribuuesve që kanë hapur llogari në eTrusti deri në fund të TM3 arriti në 57,163 ose një rritje prej mbi 2% nga tremujori paraprak. Shërbimi eTrusti ofrohet falas dhe çdo kontribuues mund të hapë llogari duke vizituar adresën në vijim:
<https://online.trusti.org/>

BOTUES:

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
Tetor 2016

REDAKTOR:

Vërshim Hatipi

AUTOR:

Jeton Demi

KONTAKT:

Rr. "Agim Ramadani" Nr. 10,
10000 Prishtinë

Shërbimet për klientë: +381-38-600-025

Zyra Qendrore: +381-38-244-341

info@trusti.org

www.trusti.org